# DËSHMI ARKIVI

**A-462956**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | “Ka rënë shteti, Kuvendi flet për s*ksin e engjëjve”, përplasje te “Ligjet” pas skandalit me SHISH-in, demokratët kërkojnë mbledhjen e Këshillit të Sigurisë |
| ADRESA | `https://newsbomb.al/politike/ka-rene-shteti-kuvendi-flet-per-sksin-e-engjejve-perplasje-te-ligjet-pa-i401886` |
| BURIMI | newsbomb.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 23 shtator 2026, 18:54:39 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 23 shtator 2026, 09:06:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `a6b1a8d0d03641b9834a9a5df5e851597195e6706ee0508c5840871fd862bde8` |
| TEKSTI | `323384ab30ba399957a052f7423d4956ccb01f7e124d9a7d74fc6de7dca487f3` |
| PAMJA | `c7dc88403a7835be93876d83d374ff2a811f1599849c9806b5bf805c9b1bbdbd` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `4b71866a37f25f7cf46b8215a07730e50da02a899d4c7e442de2548a61130aae` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/4b71866a37f25f7cf46b8215a07730e50da02a899d4c7e442de2548a61130aae`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Hapësire reklamuese



Politikë

23 Shtator 2026, 11:06

# “Ka rënë shteti, Kuvendi flet për s*ksin e engjëjve”, përplasje te “Ligjet” pas skandalit me SHISH-in, demokratët kërkojnë mbledhjen e Këshillit të Sigurisë

Shkruar nga Newsbomb



Pamje nga mbledhja

Mes përplasjeve dhe debateve të forta ka nisur këtë të mërkurë mbledhja e Komisionit për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike. Në qendër të diskutimeve është vendosur zhvillimi i një dite më parë, kur Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar vendosi masa sigurie ndaj Vlora Hysenit, e cila ka mbajtur postin e drejtoreshës së Shërbimit Informativ të Shtetit.

SPAK ka kërkuar ndaj Hysenit masën e sigurimit “arrest në shtëpi”, si dhe pezullimin nga detyra, nën dyshimin se ka nxjerrë sekrete shtetërore dhe ia ka komunikuar ato biznesmenit të arrestuar Ergys Agasi, i cili është nën hetim në kuadër të dosjes së AKSHI-t.

Ka qenë deputeti demokrat, Oerd Bylykbashi, i cili ka kërkuar që të mblidhet Kuvendi dhe të diskutojnë për këtë ngjarje të cilën e ka konsideruar si një “skandal” dhe se krimi i organizuar ka depërtuar deri në strukturat më të rëndëisshme të shtetit.

Në të njëjtën linjë ka qenë edhe deputeti Saimir Korreshi, i cili ka ironizuar vijimin e

Revista




Abonohu tani dhe lexoje

Lajmet e fundit



Bota
Rusia godet qendrat e të dhënave në Kiev, ndërpritet interneti për 100 mijë familje



Aktualitet
GJKKO e do në burg për trafikimin e dhjetërave ton kokainë, PRANGOSET në Rusi i shumëkërkuari Shpëtim Aliu, "shoku" i Eldi Dizdarit pritet t'i dorëzohet Shqipërisë (DETAJE)

Zbulo më shumë artikuj

punimeve parlamentare sikur nuk ka ndodhur asgjë, duke ngritur pikëpyetje mbi prioritetet e Kuvendit në një moment kur sipas tij janë në diskutim çështje që lidhen drejtpërdrejt me sigurinë kombëtare.

***Oerd Bylykbashi:*** *Rend dite sot, në çdo komision, në seance plenare, është skandali i djeshëm. Kjo reforma që i sillni shqiptarëve për t'ia nxirë jetën shqiptarëve, ka për sfond skandalin e djeshëm kreu i shish që arrestohet nga SPAK për lidhje me krimin e organizuar. Ky shtet është i krimbur nga koka te këmbët, ky kuvend diskuton për seksin e engjëjve. Flet për gjërat që do t'ia bëjnë më keq jetën. Ky Kuvend duhet të mblidhet sot. Si ka mundësi që krimi i organizuar të jetë penetruar te SHISH, AKSHI, kadastra, ministritë, sistemi i prokurimit,. Një shtet i rënë. Se mos ia vini fajin vetëm drejtoresha po Agasit, është kryeministri. Ajo është një lungë e sistemit që është i infektuar në të gjitha qelizat e veta, me një emër infeksioni, Edi Rama.*

***Manja:*** *Veprimtari normale e institucioneve në një shtet demokratik.*

***Korreshi:*** *Mendovca se kishte ardhur Bajromi për të mbledhur Këshillin e Sigurisë, se ka rënë shteti ka rënë siguresat gjithë. Ne vazhdojmë sikur këtu s'ka ndodhur asgjë, do bëjmë koperativa të tipit lart, apo të mesëm, të tipt bujqësor. Ky kuvend a ka ndonjëherë prioritete, kur bie siguria kombëtare. Sot kush e ruan shtetin tonë. Bajrami dini gjë ku është.*

***Blushi:*** *Prioritetet në komisionin e ligjeve duhet të jenë respektimi i ligjit dhe kushtetutës. Ky komision është përgjegjës për ti garantuar këto. Jemi në kushtet kur arkitektura e shtetit ka rënë, ku siguria kombëtare ka rënë, s'besoj se ka prioritet më të madh për një Komision Ligjesh sesa të mbajë një qëndrim lidhur me një çështje e cila cenon kushtetutën dhe sigurinë kombëtare të një vendi anëtar të NATO. Sot Shqipëria është pa SHISH, se u faktua që ky shërbim kontrollohej nga krimi, mafia. Është pa polici shteti, se policia është dorëzuar në duart e krimit. Pa ministri mbrojtje, se është dorëzuar në duart e mafies. Edhe pa këshill të sigurimit kombëtar se anëtarët janë përfaqësues të mafies. Në këto kushte s'besoj të ketë prioritet më të madh për këtë komision se mbajtja e një qëndrimi për rikthimin e ligjshmërisë mbrojtjes së republikës se sa një projektligj që forcon axhendën shpopulluese.*

## Sondazh

Poll

## Lexo gjithashtu




E Mërkurë 20:16 Newsbomb

# "Shteti i gysrave!" Salianji "shpërthen" pas arrestimit të shefes së SHISH: Qeveria e Ramës ka ulur pantollonat para krimit (REAGMI)










Politikë

PD mbledh kryesinë në mbrëmje, merret VENDIMI për qëndrimin politik ndaj Ramës pas skandalit me Vlora Hysenin

E Mërkurë 19:44 Newsbomb

Politikë

Klodiana Lala paralajmëron nga zyra e Fevziut: Mbaje shënim, do dalin të dhëna që s'i kishte imagjinuar ndonjëherë

E Mërkurë 14:08




E Mërkurë 13:35

## Reforma territoriale: 3,500 qytetarë u dëgjuan, Mazniku: Bashki më të forta, shërbime më cilësore dhe më shumë mundësi nga fondet e BE-së






Politikë

Ish-kreu i SPAK ia firmosi masat e sigurisë, gazetari jep detaje: Vlora Hyseni pinte kafe njëherë në javë me Altin Dumanin...

E Mërkurë 13:08

Politikë

Akuzat e opozitës, ministrja Spahiu pret në zyrë qytetarin: Rastin e Albi Sulës do ta ndjekim në Turqi! Mos bëni politikë me shëndetin e tij

E Mërkurë 11:39




E Mërkurë 10:08

# Një ditë pas goditjes së SPAK ndaj SHISH-it, demokratët mblidhen në seli, Berisha thërret Kryesinë e re



Politikë

Balla dhe Tarquinio dalin me DEKLARATË për takimin dyditor për anëtarësimin në BE: Gati deri në fund të 2027

E Martë 17:08 Newsbomb



Politikë

"Edi Rama të kthehet nga Amerika dhe të japë dorëheqjen", Erald Kapri kërkon që vendi të shkojë në zgjedhje: Sot shteti ka rënë, jemi turpëruar!

E Martë 15:27




E Martë 13:25

# Besmir Veli: Histori, kulturë, tradita, kulinari, natyrë...i gjeni të gjitha këtu në Delvinë



Politikë

Kthimi i Edi Ramës nga Amerika, Flamur Noka thirrje SPAK pas akuzave për shefen e SHISH dhe Ilir Prodën: Priteni në aeroport dhe çlironi vendin!

E Martë 13:12




Politikë

Sali Berisha flet për takimet e Vlora Hysenit dhe Ergys Agasit: Darkonin te restoranti pranë shtëpisë time, i bëj thirrje FBI-së ta arrestojë

E Martë 12:31





E Martë 11:27

**SPAK masë arresti për Vlora Hysenin, reagon Fatmir Xhafaj: Ndodhin në të gjithë botën, fenomene të tilla janë normale për një shtet të konsoliduar**

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.